



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 492 / Prot.

Tiranë, më 16/3 /2017

VENDIM

Nr. 51, datë 16/3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra "Lex Ferenda", përfaqësuar nga Znj. _____, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1435 Prot., datë 13.12.2016, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Ministria e Energjisë dhe Industrisë" (në vijim quajtur "Autoriteti Publik").

Ankuesi, nëpërmjet shkresave të datës 18.10.2016 dhe 28.10.2016, ka paraqitur pranë Autoritetit Publik, kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit "HEC Ternova", me shoqëri zbatuese të projektit TEODORI 2003 me NIPT K42301006L.*
2. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Stavec I, HEC Gjini, HEC Blishta, HEC Klosi, HEC Domi, HEC Luca, HEC Shoshaj, HEC Zenishti, HEC Burreli", me shoqëri zbatuese të projektit MATI HYDROPOËER me NIPT L22212004A.*
3. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit "HEC Cernaleve", me shoqëri zbatuese të projektit HIDROALBANIA ENERGJI me NIPT K984202020.*
4. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Dragobia, HEC Cerem", me shoqëri zbatuese të projektit DRAGOBIA ENERGY me NIPT K92025004T.*
5. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit "HEC T-Plan", me shoqëri zbatuese të projektit TPLANI HC me NIPT L09702601M.*
6. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit "HEC Koka I", me shoqëri zbatuese të projektit SNOË Energy me NIPT L06614401F.*
7. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Gojan, HEC Gjegjan, HEC Peshqesh, HEC Ura e Fanit, HEC Fangu", me shoqëri zbatuese të projektit AYEN AS ENERGJI me NIPT L11731504A.*
8. *Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit "HEC Vinjoll", me shoqëri zbatuese të projektit KOMP ENERGJI me NIPT K82318002A.*

9. Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Bulqiza, HEC Zërzan", me shoqëri zbatuese të projektit ESSEGEI-SHQIPËRI me NIPT K12314001K
10. Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Lena1;2;2-A", me shoqëri zbatuese të projektit GAMA ENERGY me NIPT K92224004U.
11. Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Rapun 1;2", me shoqëri zbatuese të projektit C&S Construction Energy me NIPT K819114029T.
12. Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Gurshpat 1&2", me shoqëri zbatuese të projektit GUR SHPAT ENERGY me NIPT K91425017O.
13. Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit "HEC Kalivaç", me shoqëri zbatuese të projektit KALIVAC GREEN ENERGY shpk K72326018B.
14. Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit "HEC Lengarica", me shoqëri zbatuese të projektit LENGARICA & ENERGY me K83026602A.
15. Një kopje të kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve "HEC Qafë Shulit 1,2,3", me shoqëri zbatuese të projektit HOXHA-ENERGY me NIPT L12608205L.
16. Një kopje të kontratës së koncesionit së firmës BOT për ndërtimin e hidrocentralit "Driza 1", lidhur nga Ministria e Energjisë, Tregtisë dhe Energjitikës (Autoriteti Kontraktues) me Bashkimin e Përkohshëm të shoqërive "Gerti-Metal" shpk dhe "Everest" shpk (Koncesionari), me Nr. 10285 Rep & Nr. 3309 Kol., datë 06.09.2013, duke përfshirë dokumentat si më poshtë:

- Projektin e Zbatimit
- Relacionin e kushteve gjeologjiko-inxhinjerieke
- Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
- Lejen e përdorimit të ujit
- Lejen arkeologjike
- Lejen Mjedisore

Lidhur me kërkesën e datës 18.10.2016, Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 524/1 Prot., datë 11.11.2016 duke konfirmuar se: "...Kontratat e Koncesioneve për hidrocentralet e cituara në kërkesë, në zbatim të Ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për Koncesionet", i ndryshuar, janë aktualisht në fuqi". Me shkresën nr. 6489/2 Prot., datë 10.11.2016 Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën e datës 28.10.2016 duke konfirmuar se: "...Kontrata e Koncesionit e formës "BOT" për ndërtimin e hidrocentralit "Driza 1", lidhur nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (Autoriteti Kontraktues) me Bashkimin e Përkohshëm të shoqërive "Gerti-Metal" sh.p.k dhe "Everest" sh.p.k (Koncesionari), me Nr. 10285 Rep., Nr. 3309 Kol., datë 06.09.2013 është aktualisht në fuqi".

Pas refuzimit të dhënies së informacionit sipas objektit të kërkesave nga Autoriteti Publik, ankuesi pretendon se në shkresat e cilësuara si kthim-përgjigje pohohet se kontratat janë aktualisht në fuqi por nuk janë vënë në dispozicion. Për këtë arsye, me datë 14.11.2016 Qendra "Lex Ferenda" ka përsëritur kërkesat duke paraqitur dhe informacionet e nevojshme për të evidentuar kontratat përkatëse të koncesioneve. Me shkresën nr. 6807/4 Prot., datë 12.12.2016, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke i vendosur në dispozicion kërkuarit informacion të pjesshëm në lidhje me kërkesat e datës 14.11.2016.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka vijuar ankimin nr. 1435/1 Prot., datë 21.12.2016 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit nga autoriteti publik.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr.1435/2 Prot, datë 22.12.2016, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të cilësuar Autoritet Publik përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 27.12.2016. Me shkresën 6807/6 Prot., datë 30.12.2016 Autoriteti Publik ka kërkuar “shtyrjen e afatit” për trajtimin dhe vlerësimin e kërkesës brenda datës 10.01.2017.

Pas kalimit të këtij afati, Autoriteti publik është përgjigjur më shkresën nr. 6807/12 Prot., datë 23.01.2017 duke sqaruar se kontratat, të cilat nuk janë miratuar me VKM, por kanë hyrë në fuqi me nënshkrimin midis palëve kanë në përmbajtjen e tyre nenin “Konfidencialiteti”, ku përcaktohet se: *“Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjithë dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t’ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate”*. Për sa i përket kontratave të miratuara me VKM si më poshtë: *Kontrata e koncesionit e formës “BOO” (Ndërtim-Operim-Pronësi) për ndërtimin e hidrocentraleve “Ternove” dhe “Zalli i Bulqizës”, miratuar me VKM nr. 556, datë 01.08.2003; Kontrata e koncesionit e formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit të Matit, miratuar me VKM nr. 673, datë 03.10.2012; Kontrata e koncesionit e formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) për ndërtimin e hidrocentraleve “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh”, “Ura e Fanit” dhe “Fangu” (kaskada e hec-ve mbi lumin Fan), miratuar me VKM nr. 365, datë 04.05.2011; Kontrata e koncesionit e formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentraleve “Rapun 1” dhe “Rapun 2”, miratuar me VKM nr. 717, datë 14.05.2008; Marrëveshja e koncesionit e formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentralit të Kalivaçit, miratuar me VKM nr. 222, datë 24.05.1997; Kontrata e koncesionit e formës “BOT” për ndërtimin e hidrocentralit “Lengerica 1” dhe “Lengerica 2”, miratuar me VKM nr. 543, datë 01.05.2008 si dhe Kontrata e koncesionit e formës “ROT” (Rehabilitim-Operim-Transferim) për rehabilitimin e hidrocentraleve vendore, miratuar me VKM nr. 467, datë 03.10.2002, janë kontrata të aksesueshme nga çdo subjekt në website-in e botimeve zyrtare. Lidhur me dokumentacionin teknik të kërkuar për “Hec Driza 1”, Autoriteti Publik është shprehur se përveçse konsiderohet konfidencial, nuk disponohet fizikisht prej tij, pasi projekti vlerësohet dhe qëndron në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.*

Nga shqyrtimi i ankimit dhe nga konsultimi i legjislacionit përkatës rezulton se, informacioni i kërkuar nga Qendra “Lex Ferenda”, pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, në shqyrtimin e çështjes gjejnë zbatim dhe dispozitat e Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (në vijim quajtur “Ligji për Prokurimin Publik”) dhe Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik/ privat”.

Lidhur me pikat 1, 2, 7, 11, 13 dhe 14 të kërkesës, për të cilat Autoriteti Publik në shkresën nr. 6807/12 Prot., datë 23.01.2017 ka sqaruar se është informacion i aksesueshëm në website-in e

botimeve zyrtare, bazuar në pikën 2 të nenit 16 të Ligjit “Për të drejtën e informimit”, përcaktohen qartë mënyrat e dhënies së informacionit për kërkuuesin, duke specifikuar adresën e saktë se ku mund të gjenden të gjitha kontratat e miratuara me VKM përkatëse.

Në lidhje me informacionin e kërkuar në pikat 3, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 15, për të cilat Autoriteti Publik pretendon se është konfidencial, fakt i paprovuar me asnjë dokument shoqëruar, në bazë të nenit 21 të Ligjit për Prokurimin Publik, përcaktohet se: *“Informacioni i administruar, sipas nenit 12, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”*.

Për sa i përket dokumentacionit të kërkuar në pikën 16, bazuar në pikën 2 të nenit 12, Autoriteti publik që nuk e zotëron informacionin e kërkuar, jo më vonë se 10 ditë kalendarike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent duke e vënë në dijeni kërkuuesin.

Bazuar në nenin 15 të Ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik/ privat”, parashikon se dispozitat e ligjit të prokurimit publik, që rregullojnë konfidencialitetin, zbatohen edhe për koncesionet/partneritetet publike private të rregulluara me këtë ligj.

Rrjedhimisht, neni 25 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton kufizime mbi Autoritetin Publik lidhur me publikimin e informacionit të marrë nga operatorët ekonomikë, të cilësuar si konfidencial, duke përfshirë në këtë kategori aspektet teknike, sekretet tregtare si dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

Sa më sipër, rezulton se kufizimet e pasqyruara në legjislacionin e zbatueshëm nuk prekin në mënyrë tërësore informacionin e kërkuar dhe rrjedhimisht refuzimi i dhënies së dokumentacionit është bërë në kundërshtim me pikën 6 të nenit 17 i cili përcakton se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Bazuar në Ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Ligjin nr. 9643, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik/ privat”, vlerësohet se nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar, pjesa tjetër duhet t’i vendoset në dispozicion kërkuuesit.

Për sa më lart personat përgjegjës për dhënien e informacionit të kërkuar duhet të procedojnë me dhënien e informacionit/ dokumentacionit duke respektuar referencat ligjore të cituara me sipër.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën Qendrës Lex Ferenda, përfaqësuar nga Znj. kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënien e informacionit, ankimi duhet pranuar pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin në mënyrë të pjesshme të ankesës së Qendrës Lex Ferenda, përfaqësuar nga Znj. , Nr. 1435 Prot., datë 13.12.2016, ndaj Autoritetit Publik, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informim duke zbatuar kufizimet e nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe ato të nenit 25 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2011 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, brenda datës 24. 3.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 16. 3.2017.

